



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2019:113895
Datë: 21.03.2024
Numri i dokumentit: 05485790

Ac.nr.5903/22

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Besnik Feak - Kryetar i Kolegjit, Halide Reka dhe Ardian Ajvazi, anëtar të kolegjit, në çështjen juridike-kontestimore të paditësit B. K. e S. (BKS) me seli në P., të cilën me autorizim e përfaqëson O.Q. , kundër të paditurit F. I. nga Prishtina, për çështjen kontestuese rimbursim i dëmit, duke vendosur në lidhje me ankesën e të paditurit të ushtruar kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Ferizaj-Dega në Kaçanik, Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.166/17, i datës 14.07.2022, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë **21.03.2024**, nxjerr këtë:

A K T G J Y K I M

I. REFUZOHET SI E PA BAZUAR, ankesa e të paditurit F. I. nga P., ushtruar përmes përfaqësueses së përkohshme të të paditurit avokate M. B. nga Prishtina, ndërsa Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Ferizaj- Dega në Kacanik, Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.166/17, i datës 14.07.2022, në pikën **I** dhe pikën **IV** të dispozitivit të tij, **VËRTETOHET**.

II. Pikat **II** dhe **III** të dispozitivit të Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Ferizaj- Dega në Kacanik, Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.166/17, i datës 14.07.2022, **ngelin të pa shqyrtuara**.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë me aktgjykimin e atakuar, C.nr.166/17, të datës 14.07.2022, ka vendosur si në vijim:

I. APROVOHET pjesërisht si e bazuar kërkesëpadia e paditësit B.K. e S. (BKS) me seli në Prishtinë dhe **DETYROHET** i padituri F. I. nga Prishtina, që paditësit t’ia paguaj shumën prej

3,836,00 euro, në emër të rimbursimit të dëmit, për përgjegjësin prej 80% të kontributit në shkaktimin e aksidentit, këtë shumë me kamatë si për mjetet e deponuara në bankë pa destinacion të caktuar të afatizuara mbi një vit, duke filluar nga data 05.07.2022 e deri në pagesën definitive.

II. REFUZOHET pjesa tjetër e kërkesëpadisë mbi shumën e gjykuar, për shumën prej 959.00 euro si e pa bazuar për shkak të përgjegjësis prej 20% edhe të pjesëmarrësit tjetër në këtë aksident të komunikacionit.

III. DETYROHET pala paditëse që kësaj gjykate t'ia paguaj shumën prej 40 euro në emër të taksës për padi, e cila pagesë do të bëhet në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit në dorëzim të këtij aktgjykimi.

IV. DETYROHET i padituri që paditësit t'ia paguaj shumën si në pikën I të këtij dispozitivi si dhe shpenzimet e procedurës kontestimore në shumën prej 290 euro (290-20% për përgjegjësin prej 80%, e për pagës mbetet shuma prej 232 euro), të gjitha këto pagesa do të paguhet në afat prej 15 ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit, nën kërcënimin e ekzekutimit me dhunë.

Kundër këtij aktgjykimi në afatin ligjor ankesë ka paraqitur i padituri, për shkak të konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, dhe për shkak të zbatimit të gabuar të së drejtës materiale me propozim që Gjykata e Apelit, ankesën ta aprovojë si të bazuar dhe ta ndryshojë aktgjykimin e atakuar duke e refuzuar kërkesëpadinë e paditëses si të pathemeltë.

Paditësja, nuk ka ushtruar përgjegje në ankesë.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar, në mbështetje të nenit 194 dhe 195 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

Ankesa e të paditurit, F. I. nga P., ushtruar përmes përfaqësueses së përkohshme të të paditurit avokate M. B. nga Prishtina, është e pa themeltë.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësja, paditësja B. Ko. e S.t përmes përfaqësueses së saj të autorizuar O. Q., me datë 31.07.2017 ka ushtruar padi për rimbursim dëmi ndaj të paditurit F.I. nga Prishtina. Paditësja ka theksuar se me datë 13.11.2014 rreth orës 15: 30, në rrugën e fshatit Vrellë- Istog, tek pompa e derivateve "E." është shkaktuar aksident komunikacioni me fajin primar të paditësit sepse i njëjti e fillon çkyqjen nga rruga për në anën e majtë, pa u bindur se veprimin e kthimit majtas mund ta bënte në mënyrë të sigurt pa i rrezikuar pjesëmarrësit tjerë në komunikacion, si dhe duke mos u rreshtuar në mënyrë të duhur (ishte duke lëvizur në mes të rrugës) dhe pasi kalon në shiritin e kundërt qarkullues (ku kalon jashtë rruge), ku lenë gjurmë të bartjes së frenimit me gjatësi prej 8.26m, në atë moment nga kahja e kundërt ishte duke lëvizur njësia B dhe shoferi i kësaj njësie kur e sheh rrezikun fillon frenimin ku bartet dhe lenë gjurmë me gjatësi prej 20.3m, por prap me pjesën e parë e godet njësin A, po ashtu i njëjti në momentin e shkaktimit të aksidentit nuk ka pasur polisë valide të sigurimit me ç 'rast sipas LSDA-së BKS është përgjegjëse për kompensimin e dëmit të shkaktuara nga automjetet pa sigurim, ku e njëjta

e ka kryer procedurën e kompensimit dhe pas përfundimit të saj i jepet e drejta të kërkojë regres. Gjykatës i propozojë ta aprovojë si të bazuar kërkesëpadinë dhe ta detyroj të paditurin që paditësit t'ia paguaj shumën prej 4,795,00 euro, në emër të rimbursimit, këtë shumë e ka kërkuar me kamat si për mjetet e deponuara në bankat afariste të Kosovës pa destinacion të caktuar me afat mbi një vit. Shpenzimet i ka kërkuar.

Përfaqësuesja e përkohshme e të paditurit F. I. , avokate M. B. nga Prishtina e ka kundërshtuar kërkesëpadinë e paditëses duke i propozuar gjykatës që të njëjtën ta refuzon sepse nuk kemi prova apo vendim në bazë të secilit i padituri është shpallur fajtor për aksidentin e shkaktuar. Përfaqësuesja e përkohshme ka theksuar se ekspertizën e ekspertit të komunikacionit e ka pranuar dhe në të njëjtën nuk ka vërejtje dhe i ka propozuar gjykatës që në bazë të provave të cilave gjenden në shkresat e lëndës të nxjerrë vendim meritor. Shpenzimet i ka kërkuar.

Gjykata e shkallës së parë duke vepruar sipas padisë së paditëses, ka caktuar seancë gjyqësore dhe pas shqyrtimit dhe administrimit të provave të paraqitura nga palët ndërgjyqëse si dhe vlerësimit të të gjitha shkresave tjera të lëndës ka nxjerrë aktgjykimin e atakuar C.nr.166/17 të datës 14.07.2022, me të cilin e ka aprovuar pjesërisht kërkesëpadinë e paditëses, duke vendosur më decidivisht si në dispozitiv të aktgjykimin të atakuar.

Në arsyetim të aktgjykimin të atakuar, gjykata e shkallës së parë, ka theksuar se nga raporti i policisë për aksidentin numër DR-3004-688-14 të datës 13.11.2014, dhe shkresat e tjera në lëndë, gjykata vërtetoi faktin se me datë 13.11.2014 rreth orës 15:30 në fshatin Vrellë Komuna Istog, ka ndodhur aksident komunikacioni. Nga ekspertiza e komunikacionit rrugor i përpiluar nga eksperti i komunikacionit Xh. M. me datë 18.06.2022 është vërtetuar fakti se aksidenti është shkaktuar me fajin e dy pjesëmarrësve në aksident ku lëshimet primare janë të shoferit të automjetit A-të paditurit dhe lëshimet sekondare janë të shoferit të automjetit B-palës së dëmtuar. I padituri e ka drejtuar automjetin “VË” 253 me targë të regjistrimit xxxx pa regjistrim po ashtu ka vepruar në kundërshtim me ligjin për rregullat e trafikut rrugor, neni 41.1 me të cilën është paraparë se shoferi i cili në rrugë ose në ndonjë hapësirë tjetër të trafikut synon të bëjë ndonjë veprim me mjet si hyrje në trafik, rreshtim, lëvizjen e mjetit në anën e djathtë ose të majtë, ndërrimin e shiritit të trafikut, tejkalimin, anashkalimin, ndalimin e mjetit, kthimin në anën e djathtë apo të majtë, kthimin gjysmë rrethor, drejtimin e mjetit mbrapa e të ngjashëm, lejohet të fillojë një veprim të tillë vetëm nëse më parë është bindur se nuk i rrezikon ose nuk i pengon pjesëmarrësit tjerë në trafik ose nuk e rrezikon pasurin. Kurse shoferi i automjetit B “VË Touran”, me targë xxxx, ka vepruar në kundërshtim me Rregullat e Trafikut Rrugor neni 53.1, ku është paraparë se shoferi duhet t'ua përshtat shpejtësinë e lëvizjes kushteve dhe fushëpamjes së rrugës, gjendjes dhe llojit të rrugës, kushteve teknike, atmosferike, ngarkesës së mjetit, dendësisë së trafikut, gjendjes psiko-fizike të tij dhe aftësive personale të tij, ashtu që të jetë në gjendje ta ndalë mjetin para çdo pengese që mund të paraqitet në kushte të dhëna brenda kufijve të fushëpamjes, përkatësisht të mund të veprojë me kohë. Paditësja e ka zhëmtuar të dëmtuarin, andaj i padituri ka detyrim ta kompensoj paditësen ashtu që gjykata e aprovoi pjesërisht kërkesëpadinë e paditëses duke e bazuar vendimin e saj në nenin 14 paragrafi 3 të Ligjit për Sigurimin e Detyrueshëm nga Auto përgjegjësia. Gjykata vendosi si në pikën e dytë të dispozitivit duke e refuzuar shumën përtej asaj të aprovuar për paditësen, për faktin se se nga

ekspertiza e komunikacionit ishte konstatuar se përgjegjësia në aksidenti ishte 80% e të paditurit në raport me 20 % të përgjegjësishë të dëmtuarit. Për sa i përket llogaritjes së kamatës, gjykata vendosi që kamata të paguhet sipas mjeteve të deponuara në bankat afariste në Kosovë pa destinacion të caktuar dhe të afatizuara mbi një vit, duke filluara nga data 05.07.2022, (data e seancës kryesore), e deri në pagesën definitive, ndërsa për shpenzimet e procedurës vendosi sipas nenit 452 të LPK-së.

Gjykata e Apelit nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson së qëndrimi dhe përfundimi juridik i gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika (b), (g), (j), (k) dhe (m) e LPK dhe se e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë, për të cilat shkaqe Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të dispozitës së nenit 194 të LPK, në ndërkohë që edhe gjendja faktike në këtë procedurë është provuar drejtë dhe në mënyrë të plotë.

Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit dispozitivi i aktgjykimit të atakuar është mjaft i qartë, rrjedhimisht edhe i përmbarueshëm, e në përputhje të plotë me arsyet e aktgjykimit duke qenë kështu në harmoni logjike dhe juridike dispozitivi me arsyetimin. Gjykata e shkallës së parë ka dhënë arsye të mjaftueshme për mënyrën e vendosjes në këtë çështje juridike kontestimore duke arsyetuar të gjitha faktet vendimtare të cilat kanë ndikuar që e njëjta të vendosë si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar, të cilat arsye janë të pranueshme edhe për gjykatën e shkallës së dytë. Po ashtu sipas vlerësimit të kësaj gjykate, në mes të arsyeve të paraqitura nuk ekzistojnë kundërthënie, në ndërkohë që kundërthënie nuk ka as në mes të dispozitivit dhe arsyetimit të aktgjykimit.

Gjykata e Apelit e refuzon si të pabazuar pretendimin e të paditurës për vërtetimin të gabuar apo jo të plotë të gjendjes faktike ngase gjendja faktike në këtë procedurë është vërtetuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë ku mbi bazën e kësaj gjendje faktike të vërtetuar është aprovuar pjesërisht kërkesëpadia e paditëses, rrjedhimisht drejt është zbatuar edhe e drejta materiale. Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, në rastin konkret, nuk ka qenë kontestues fakti se me datë 13.11.2024 ka ndodh aksidenti i komunikacionit, megjithatë i njëjti fakt u vërtetua edhe nga raporti i policisë për aksidentin numër DR-3004-688-14 të datës 13.11.2014, ndërsa me nxjerrjen e provës me ekspert komunikacioni u vërtetua edhe shkaktari i aksidentit dhe kontributi eventual i pjesëmarrjeve në aksident, andaj mos ekzistimi i vendimit gjyqësor që të paditurin e shpall fajtor për shkaktimin e aksidentit nuk e amnistion të paditurin nga përgjegjësia për kompensimin e dëmit të shkaktuar në domenin civil e i cili dëm në rastin konkret është vërtetuar përmes ekspertizës së ekspertit të komunikacioni.

Gjykata e Apelit, vlerëson se gjykata e shkallës së parë, mbi bazën e gjendjes së vërtetuar faktike, drejtë ka zbatuar edhe të drejtën materiale sa i përket lartësisë së kërkesëpadiës përderisa baza juridike e të njëjtës nuk ishte kontestuese kur me rastin e vendosjes, i është referuar nenit 18 paragrafi 3 të Ligjit për Sigurimin nga Auto përgjegjësia nr. 04/L-118 ku përcaktohet detyrimi i siguruesit që në rastet e paraqitjes së rastit të siguruar të paraqitur nga aksidenti i komunikacionit me mjet motorik, të kompensoj dëmin e pësuar palët e treta pa fajin e tyre, e në rastin konkret, përderisa i padituri ka ngarë automjetin pa mbulesë siguroese, respektivisht me policë të skaduar

të sigurimit, atëherë, përgjegjësia për kompensim të dëmit sipas nenit 14 paragrafi 1 pika 1.2 dhe 1.3 dhe paragrafi 3 të Ligjit për Sigurimin nga Auto përgjegjësia nr. 04/L-118, ku parashihet se *“Siguruesi pas përmbushjes së detyrimit nga ky nen dhe paragrafi 3. i nenit 9 të këtij ligji, ka të drejtë të kërkojë rimbursim në procedurë regresi ndaj personit përgjegjës për dëmshpërblimin e paguar, edhe pse personi nuk kishte mbulesë siguruese”*, ndërsa sa i përket lartësisë së dëmit material të gjykuar nga gjykata e shkallës së parë, e njëjta ka vendosur drejtë ngase me nenin 169 paragrafi 1 dhe 3, në lidhje me nenin 173 paragrafi 1 ku përcaktohet e drejta e të dëmtuarit që në rastet e pamundësisë së kthimit në gjendje të mëparshme për dëmin material, shpërblimi të njëjtit ti jipet në të holla, dhe se gjykata e shkallës së parë, duke marrë për bazë të mirat e cenuara në rastin konkret drejtë dhe në proporcion ka caktuar kompensimin e dëmit material si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës është në përputhje me veprimet e ndërmarra në këtë çështje juridike kontestuese dhe në pajtim me dispozitat e nenit 449 dhe 452 të LPK-së.

Meqë, aktgjykimi i ankimuar nuk është goditur me ankesë në pikën **II** dhe **III** të dispozitivit të tij nga pala me interes juridik, gjykata e shkallës së dytë, duke iu përmbajtur kufizimit ligjor të mjetit juridik (kufinj të ekzaminimit të aktgjykimit të ankimuar), sipas nenit 194 të LPK-së, si dhe Institutit “Reformatio in Peius” nga neni 203 i LPK-së, këto pika të aktgjykimit të ankimuar nuk i shqyrtoi fare.

Gjykata i shqyrtoi edhe pretendimet e tjera ankimore por të njëjtat ishin pa ndikim për një vendimmarrje ndryshe nga ajo që u vendos në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Nga të lartë cekurat e në mbështetje të dispozitës së nenit 194, 195.1 pika d), lidhur me nenin 200, të LPK-së, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
Ac.nr.5903/22, me datë 21.03.2024

Kryetari i Kolegjit-Gjyqtari
Besnik Feka